


PAVARËSJA

Fletushkë e SHLT-së dhe e grupit letrar
"HASAN PRISHTINA" FERIZAJ

VITI I/1
maj '91

*Dhe, para së gjithash, ruhani nga mallkimi i historisë
dhe mos e harroni atë kur ta japni mendimin tuaj!"*
Hasan Prishtina







LEXUES TE NDERUAR

QËNDRESA

NUHI BERISHA

Duke ndier nevojën për një fletushkë, ku do të gërshetoheshin hallet, brengat e preokupimet të studentëve në përditshmërinë tonë jo të zakonshme. ku do të përsfiheshin më gjërsisht interesat dhe problemet e gjithëmbarshme studenteske si nga raporti student-profesor, si në stimulimin e ngritjes më efektive të nivilit të studimeve, si me gjendjen e mjerueshme të kushteve materialo-finansiare të studentëve e sidomos atyre që janë nga viset e ndryshme shqiptare të Republikës së Kosovës, të cilët banojnë apo udhotojnë, e ku vijimi i mëtutjeshëm i studimeve të tyre është imperativ i kohës me botkuptimet e persiatjet tona në lidhje me çështjen gjithëshqiptare përbalë orëve të liga që po sillen vërdallë mbi ne, që edhe ne si një pjesë më vitale e kombit të lëmë gjurmë për të ardhmën si ndërgjegje e jona.

Ne studentët e UPS-së të SHLT në Ferizaj, në mbledhjen e mbajtur ditë më parë vendosëm që të nxjerim organin tonë, fletushkën "PAVERESIA" në kuadër të grupit letrar "HASAN PRISHTINA" të udhëhequr nga vetë studentët në bashkpunim me grupin letrar të qytetit dhe me nxënës të shkollave të mesme.

Në kuadër të kësaj fletushke do të prezantohen edhe krijuesit e rinjë të cilët deri më tani nuk kanë pasur rastin të prezantohen para lexuesve të pasioniar me punimet e tyre si në prozë ashtu edhe në poezi. Pra "PAVERESIA", është zëri i ndërgjegjes sonë, i pjekurisë sonë.

"Si do ta njohësh vetëvetën? Duke e shikuar-asesi, por duke vepruar. Orvatu ta kryesh detyrën, obligimin tëndë dhe menjëherë do ta shohësh sa vlenë", është një nga maksimat më të njohura të J. V. Gëtes.

Prandaj mos të vonohemi. Cdo minutë e humbur është një hap i vonuar i yni. Koha punon për ne, e ardhmja është e jona.

ME FATË!
Bujar Bajraktari

Kërbaç i ubashëve trupin tuaj mavjos, e nga goja juaj nuk del sjalë, as gjëmë; të tërbuar nga qëndresa juaj heroike sillen ubashët si kuajt në lëmë.

Torturat barbare vazhdojnë pandërpre e ju nuk e njihni asnjeherë nënshtrimin: ne mendjen tuaj thellë janë ngulitur ato netë të errta, kur e dhamë betimin.

Ju ushtojnë ende sjalët që njëzërit thamë "Betohemi se as vdekja s'do të na frikësojë" lart tani ju mban ideal i lirisë, (ndodhë n'dysheme pa ndjenja) por jo të nënshtuar para këlyshëve t'tradhtisë.

Mbi trupin tuaj, të enjtur, plot plagë ju hedhin ujë t'permendeni nga alivania, kur nga ju presin ndonjë sjalë për të treguar, pështymë si përgjegje merr n'surrat tradhtia.

Këmbë e duar lidhur ju përplasin n'qeli, ndërsa gjak rrjedh nga plaqët n'trup t'ri, po ju mbaheni të fortë si revolucionarë, se pa mund e gjak s'fitohet Liri.

Qëndresa juaj, shokë, më jep forcë e jetë, në çdo hap që eci ju ju kujtoj, ulem e marrë një copë dheu dhe në vënd tuajin atë e përqafoj.

Në këtë tokë martire, të robëruar kaherë (Këtu kemi lindur këtu do të vdesim.) në luftë me armikun fashist, gjakatar, Kosovës martire besnikë do t'i mbësim.

Edhe në burgje, atje në t'stohtat qeli ngadhnjejnë ata që luftojnë për Liri.

Nga ora letrare:

'81-'91 PERVJETORI I DEMONSTRATAVE REVOLUCIONARE

Sikurse në shumë fakultete, shkolla, shoqata, e maledise të shumta të viseve të ndryshme shqiptare në Jugosllavi, poashtu edhe në SHLT-në Ferizaj u mbajt orë letrare kushtuar dhjetëvjetorit të demonstratave revolucionare gjithëpopullre, njëherit u përkujtuan Dëshmorët e Kombit të rënë viktimi e gjenocidit dhe terorit ushtarako-politic serbosllav. Për organizimin e këtij manifestimi u angazhua Këshilli Punues i Studentëve, i reduktuar nga Kuvendi i UPS të cilët besimin e dhënë e kryen me ndërgjegje. Manifestimin edhe më madhështorë e bëri prania e profesorëve dhe mysafirëve, si dhe interesimi dhe kujdesi mjaft i madh i neve vetë studentëve. Si me pikat e zgjedhura të programit, poashtu edhe me demonstrimin që treguan studentët në recitime, të pranishmit mbetën të kënaqur. Në fundë të programit u lexuan tri kërkesat e UPS:

PETICION:

1. - Kërkojmë lirimin e menjëherëshëm të të gjithë të burgosurve politik shqiptar anë e mbanë burgjeve Jugosllave.

2. - Kërkojmë që menjëherë të funksionoj Kuvendi Kushtetutar i Republikës së Kosovës dhe institucionet tjera legjitime.

3. - Kërkojmë që sa më parë t'i kthehet imuniteti Universitetit të Kosovës dhe kthimi i gjendjes normale për punë, si dhe vijimin e studimeve të studentëve të fakultetit të mjeksisë, gjegjësisht vërtetimin e semestrave.

Peticioni - për lirimin e menjëherëshëm të të gjithë të burgosurve politik shqiptarë anë e këndë të burgjeve jugosllave, i'u dërgua Kuvendit Federativ jugosllav, organizatës ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut "AMNISTY INTERNACIONAL", si dhe mediumeve të ndryshme informative të ndryshme në gjuhën shqipe. Këtij peticioni i'u bashkangjitën mbi tre mijë nënshkrime të studentëve dhe të masës.

Menjëher pas përfundimit të orës letrare pjesa dërmuese e studentëve të prirë nga kryesia e UPS u drejtuat për në vorrezat e fshatit Nekudim për t'i bërë homazh dëshmorit Riza Matoshi, i cili

këtu e dhjetë pranvera më parë, duke kërkuar asgjë më tepër se ajo çka na takon, të drejtën e nëpërkëmbur elementare, lirinë dhe pavarsinë e kombit shqiptar në Jugosllavi, u vra nga plumbat gjakatar të shovinistëve sérboslavë, përtë mos vdekur kurr.

Në emër të UPS studenti Hajrush Musa e lexoi tekstin e përgatitur për këtë rast, si dhe studentja Shyhere Haliti Recitoi një poezi.

Pas kryerjes së homazhit në Nekudim ku me një minutë heshtje i bëmë nderim shoku, vëllaut, dëshmorit Riza Matoshi, një delegacion e studentëve shkoi në Sllatinë të Epërme për t'i bërë nderime dëshmorit Sherif Frangu i cili sikurse Riza e shumë shokë e shoqe të tjerë ranë therorë, duke u konfrontuar me hordhitë barbare të hegjemonistëve serb.

RIZA MATOSHIT E SHERIF FRANGUT

Fjalët që dua t'i them për Ju, nuk mundë t'i shprehë nga malli e shpresë që s'harrohen. Duke marrë frymë shqiptarisht, trimëruat radhët e shokëve tuaj, thuaja se në pëllëmbën tuaj ndahej lindja e perëndimi i një historie.

Histori e një pranvere të përgjakshme, kujeta ndahej nga vdekja. Barikadë e gjallë për tankset ishin gjokset tuaja, e grushtat armë me zjarre kundër padrejtësive të Serbisë.

U bëtë fli për nënë Kosovën, sepse ata katila kurrë s'ju vranë në zemrat tonë, atje ejni të gjallë si ishit në ditën e demonstratave kombëtare për nënë Kosovën.

Toka gëzohet që mbanë kësi trima, edhe dheu që jeni të mbuluar me të është pjesë e historisë me mbishkrimin amnorë...

"KËTU PUSHOJNË DY DËSHMORË"

LAVDI DËSHMORËVE TË POPULLIT TONË!

Teksti të cilin e lexoi studenti Hajrush Musa pranë varrit të dëshmorit RIZA MATOSHI.

Kryesia e Unionit të Pavarur të SHLT Ferizaj

VËLLEZËR E MOTRA

(nga një grup qytetarësh)

Në historinë e pasur të lavdishme dhe heroike të kombit tonë, pati shumë shpërthime vulkanike të masave të gjëra populllore që përcaktuan orientimet kryesore në rrugën drejt realizimit përfundimtar e të plotë të aspiratës sonë të çlirimtë kombëtar.

Kryengritja popullore-paqiore e vitit '81, e asaj pranvere të madhe masoviteti i saj, jehona dhe vendosmëria e pathyeshme për realizimin e të drejtave tona legitime, të qelnikosura me gjakun e dëshmorëve që ranë në vijën e parë të ballafaqimit me forcën e hekurt të pushtuesit, sot po e merr vulën e drejtësisë së plotë historike.

Që në nismën e asj pranvere të madhe të 3 Prillit, Ferizaji i fali radhëve të martirëve të kombit, dëshmorin 26 vjeçar Riza Matoshin.



Riza MATOSHI

Marshimi i Rizait si puntor i Kombinatit të drurit "Tefik Çanga" së bashku me shokët e tij puntër të këtij kombinati, por, edhe i gjithë puntorëvr tjerë, fshatarëve, studentëve, nxënsve, intelektualëve dhe të tjerëve, ishte hap vigan, hap i hyrjes së popullit tonë në një fazë të re të luftës çlirimtare.

Kjo dekadë lufte, është dekadë që vazhdimisht pasuroi luftën tonë me formë të reja të rrezistencës, por, edhe më shumë luftarë e dëshmorë të lirisë -dëshmon për vendosmërinë tonë të paluhatshme drejt realizimit të lirisë dhe pavarsisë kombëtare.

Akti i secën për nderimin e kuqimit të shokut e vilaut tonë Riza Matoshi, që paraqet njëkohësisht edhe nderimin e gjithë dëshmorëve të tjerë të rënë përkëtë truall. Le të shërbet si akt kushtrim për ngjeshjen e radhëve tona përvigjilencë e naturi, kushtrim përtolerancë e mirkuptim mes nesh, më menyrë që të jemi më të pashkarë e më të fortë për t'i përballuar me sukses fortunat që na presin në rrugën tonë shenjtë deri në fitoren përfundimtare.

3 Prilli e ndau Riza matoshin nga familja e tij e ngusht për ta futur përgjithmonë në familjen e madhe të gjithë popullit shqiptar, heroik e liridashës.

LAVDI DËSHMORIT TË POPULLIT RIZA MATOSHIT

NDERIME SHOKUT, RIZA MATOSHIT NGA ANAMORAVA

Nderimet tona janë pjesë e nderimeve gjithëkombëtare që i bëhen dëshmorit militant që me gjakun e tij forcoi kalanë tonë që po e ndërtojmë, kala që themellet i vunë Abfyl Frashëri me trimat e Lidhjes së Prizrenit, e vazhdoi Ismail Qemali e Isa boletini, Vojo Kushi Emin Duraku, Xheladin Hana e Jusuf Gërvalla me shokë, kala që prore po forcohet nga gjaku i bijëve dhe bijave më të mirë të këtij populli.

Radhët e dëshmorëve po shtohen, nga gjaku i kuq i tyre po mbijnë lulkuqet e Kosovës, të cilat në një të ardhme të lirisë sonë të shtrenjtë do të zbukurojnë kopshtin e krenarisë sonë, kopshtin e lulkuqeve, varrezat e dëshmorëve të kombit.

LAVDI DËSHMORIT TË POPULLIT RIZA MATOSHIT

SHEMBËLLTYRA E SHERIFIT, SINONIM PËR LIRI DHE PAVARSI

Ne këtë 10 vjetor të parë, dëshmorët anë kënd Kosovës po i përkujtojnë jo në liri por në një kohë kur okupatori i vjetër 79 vjetë po e ushtron terrorin, dhe toka shqiptare çdo pranver po çel lulekuqe gjaku, të atij gjaku të të rinjëve e fëmijëve që kur se njohtën grohtësin e liris.

Përpjekjet e këtij populli të ndar nga shteti amë kurr nuk pushuan për realizimin e aspiratave liridashëse. Shqiptareve ua ngrin të drejtat legjitime për shtet të bashkuar dhe liri sovranë në territorët e lashta shqiptare, koha e ngrir që mbretoronte në Evropën dhëlpër e cila me shpatën e interesit ia preu gjymtyrët vitale të trungut shqiptar. Çdo vitë i pushtimit 79 vjeçar solli tragjedin dhe fatëkeqsi kolektive kombëtare. Mirëpo edhe pse në kohëra të liga, populli gjeti forcë që ti sfidojë të gjitha shtypjet e padrejtësit që ju bënë. Kjo forcë burimin si gjithmon e kishte në rinin revolucionare dhe inteligjencën e pakët që lindi në ato kushte të vështira dhe pikërisht në këto rrethana ajo u bë më e kalitur, më këmbëgulëse në kërkimin e atyre të drejtave dhe asaj lirie që i takon një populli si i yni me tradita të lashta dhe zakone autoktone me shtrirje të gjerë në ballkan.

Gjeneratat që u ndëruan krahë rezistencës që i bënë pushtuesit serbo-malaluz dhe presioneve të kolonëve që erdhën dhe zunë vratat e shqiptarëve, e përcollën gjithëher mesazhin dhe porosin se pa ngritje të vetëdijes dhe angazhimin e të gjitha shtresave popullore në luftën e mundinshme, "Liria" s'mund t'i prek alpet shqiptare që qëndrojnë edhe ashtu me kreshtat drejtuar nga dielli e me shtatin e gjerë që me gjithë ndeshjet që i bëhen prap vertikalish qëndrojnë në kohëra.

Kronikë qëndresash mba të shkruar në zemër çdo shqiptar që rrënjet i ka në damarët e tokës ilire, kronikë loti e dhimbje, se këto edhe i mbollën pushtuesit serbo-jugosllav aty ku frymonin, jetonin e ëndërronin lirin shqiptarët, aty siç thonte Azem Bejta: "Bukës i thonë bukë e ujit ujë".



Sherif FRANGU

Dimra me ngricë kaluan shpesh mbi pranverat e vonuara e njerëzve ju desh të kalojnë edhe atëher kur dukej se do të zhdukeshin, aty kalitej dhe më e bukur dilte qëndresa. Pra, si linte krenaria ti gjynjëzoheshin dimëravesa do të ashpër që të ishin. E vitet për shqiptarët nën sundimin Titist nuk ishin të lehta. Viti 1981 theu edhe iluzionet e fundit se shqiptarët mund të gjëzonin edhe minimumin e të drejtave që u garantonin çdo kombi. Pikërisht me 1981 shpërtheu revolta që ziente me vite aty edhe më fort u ndi padrejtësia, flaka revolucionare, përfshiu çdo qytet e fshat. Lum njerëzish u nisën aty ku helmetat e ngurta u përplasën për trupat e njomë të nxënësve dhe studentëve, të rinis që me grusht kapnin plumbat e armikut dhe krahërorin e bënин flamur lirie. Një krahorr fshatari atë ditë prilli u bë flamur. Një ëndërr fluturoi nga sytë e hapur drejt vargmalëve të Sharrit, atje lart një karvan plisash të bardhë zbresin në qytet enjë shqiponjë i binte për fytyre Sherifit dëshmor se liria atë ditë ngjyhej me gjakun e derdhur.

Sot po përkujtojmë dekadën e parë të lindjes së dëshmorit. Shpresojmë se në përvjetorët tjerë mbi varret e dëshmorëve do të vejmë dafina të liris.

Shqipe A.

KURRË NË ROBËRI, BESA JONË NJË SHQIPËRI

*Midis katër mureve
ditët i kalojmë
me buzë në gaz
atdheut i këndoymë,
me vite të tëra
diell s'shofim me sy
po ne duam një diell
të madh, ai quhet LIRI.*

Ende i këndoynë këto këngë prapa grilave, ata që u burërëruan në burgë kur hynë si fëmijët ata që u plakën vitet e moshës së rinisë. Midisë katër mureve ëndërrat nuk ndryhen, aty del e bukur qëndresa dhe buzqeshja si lulekuqe mbinë në fytyrat e zbehura. Nga dritarëza e zënë me hekura nuk e shohin as qielin "në 40 copë", se ndesh tyre ngrihen bedene me gjemba ku thyhen edhe rrezet e fundit të diellit. Mijëra yje mbijnë në shpirtë, e dashuria rritet edhe nëpër qelira të betonta për diellin që ndiejnë. Edhe pasë shtatë dryrëve që mbajnë mbyllur legjendat e gjalla.

Liri është amaneti i mëmëdheut, se pa këtë diell, ai i ngjanë në kafazinë që mbanë të ndryrë këngët më të bukura të bilbilit.

Kronikanët tanë, vërtet do të shkruajnë kronika në gurë. Çdo udhëkryqë që ndanë udhën në katër anë do të hasi në godina mitike dhe çdo gurë do t'u rrëfej për fatin kolektiv të shqiptarëve me peranga në gjymtyrë që ishinë më të forta se guri...


Fat të tillë pati edhe profesori Sylejman Bytyqi.

Që në moshën e re, Ai e kuptoi barrën e robërisë që rëndonte mbi popullin shqiptar, fatin e tij tragjik që ia caktuan të tjerët. Me 1968 shpërtheu vullkani i urrejtjes kundrejt padrejtësive i akumular me vite të tëra. Ngritjes së mijëra zérave për çlirim të plotë kombëtar, i'u bashkua edhe ky i ri 16 vjeçarë. Për herë të parë Syla bie në kthetrat e UDB-së, ku u ballafaqua me "drejtësinë" e kërbaqitë të gjakëpirsave.

Si i mitur u denua me 60 ditë burgë. Endrra për atdheun e lirë për asnjë qastë nuk iu shuan.

Ato që e përjetoi ai në burgun e Ferizajit qëndruan të freskëta dhe kurr nuk i mbuloi pluhuri i hasrresës: sepse ç'do shqiptar e ka të gjallë muzeun e vetë të lashtë të ndryrë në zemrën e hapur e bujare për miqët, e të egër e të zjarrët për armiqët.

Vitet kalonin ejeta në robëri sa



Sylejman BYTYQI

(profesor i SHLT-s i cili ende
ndodhet në burgjet Jugosllave)

vinte e rëndohej më tepër, për tu bërë e padurushme dhe shpërtheu edhe më fuqishëm në vitin 1981, ku shumë të rinjë e të reja me gjakun e tyre stolisën ballin krenar të atdheut. Nga ky vitë fillon një valë e re terrori dhune për mbarë popullin shqiptarë. Fillojnë përgjimet ndjekje, burgosjet...

Burgoseshin të gjithë ata që kishin guxuar të mendonin ndryshe nga platforma e regjimit serbosllavë. Në nëndorë të vitit 1985 fillooi vala e arrestimeve të reje. Kjo valë e përfshiu edhe Sylejman Bytyqin (atëher si profesor në SH.L.T. në Ferizaj).

Pas gjashtë muaj hetimesh të ashpra, ku përjetoi melltretime ç'njerzore, në qershore të vitit 1986 denohet me 9 vite burgë. Tetë muaj i kalon në burgjet hetuese të Prishtinës, Gjilanit e Prizrenit. Tani është duke vuajtur deniminë burgun hetues të Zrenjaninit.

Të jeshë me mijëra kilometra largë mëmëdheut i rethuar me mura të trashe mesjetare, dhe prej mëngjesit të thithësh ajrin e urrejtjes që ta afrojnë sendet e hekurta, duhesh të jesh shqiptar për të mbetur njeri. E profesori qëndron i papërkulur si një lis shtatgjerë edhe pse i gërvishur nga stuhit e fortë...

Lumniye AZEMI

LAVI TË QOFTË

Hapu o dhe i Kosovës
të të shoh trimin,
të të shoh gjakun e shqiptarit
VËLLA BEKIM

Hapu o dhe i mëmëdheut
kam një lule për sokolin tëndë
kam një fjalë, një përshëndetje
me vëllau tim-Birin tëndë.

Zgjohu o vëlla Bekim
të shohësh bankën e shkollës,
të shohësh abetaren e fitores
REPUBLIKËN E KOSOVËS.

Jo nuk ke vdekur
je dritë e dheut,
bijtë e shqipes tok me ty
Me Kosovën për DEMOKRACI.

LAVDI TË QOFTË

Ili **RXHEPI**
nxënës

Më thuaj, o Nënë e dshur
Më thuaj, çfar të keqe bëmë
Kujt po i zëmë diellin
Në këtë kohë të vrërët.

Edhe se varre të reja, duhet t'i hapim
Edhe sa fatosave, duhet tu shkoj rrëke
gjaku
Edhe çka duhet bërë, o Nënë e mjerë
Që t'i tregojmë botës se jemi tä nderë.

Pranvera e lulkuqeve së shpejti do
të vij
E, ti me shpirtë ndër dhëmbë, çëndrosh
si hije
Të vranë e të shanë, të plaqkitën e
të helmosën
Sa bij e bija tua, o Nënë sakatosën.

Marri të çoftë ndër shekuj, ty moj
shtrigë plakë
Gjithë turpi i kohës, të mbuloftë si
plaf
Po si na e ndave Nënën nga Kullë e
gjini
Dhe e le të mjerë, në dallgë e stuhi.

Eh, sa shumë durove nga kjo mizori
Guri që është gurë, do të bëhej hi
Durim Nënë durim, durim edhe pak
Se kjo tokë martire është e ngrirë
me gjak.

E di se je lodhur, e di që je e uritur
E di se je e plagosur, e di që je
mërzitur
Gjaku i fatosave që spërkati mbi ty
Eshtë gjaku që u mbjell për Bukë, Paqe,
Liri

Fjalët rrëfyese
kshillat e tepërtë
porosia pa vend,
mbeti enigmë.

Jeta besnike
koha mallëngjyese
rasti befasë,
e vërteta rastësi.

Jo, kurrën e kurrës
jo, ashtu siç mendoje
por durimi i mirëseardhur
e çdo gjë punë e mbarë.

Duhet të mbesim krenar
nga ditët e kaluara
se errësira do të zhdukët,
e drita do të mbretëroi.

AKTI I NJË POEME (skicë)

Mëngjesi zbardhi në fytyrat e njerëzve që ngarendnin rrugëve me fatin e jetës në duar, as tytyt që mbjellin vdekjen, as moti i përvajshëm, nuk e ndali vrullin e tyre.

Ata silleshin rrotull qytetit ashtu si një grusht, dhe shiqonin nga qielli i kaltër që sikur i përpinte.

Në ballë u printe një djalosh me fytyr të zbehur, shtet e mëdhenjë e bënin të zjarrtë e krahtë e lodhur nga ditët e okupuara.

Në gjoksin e tij të gjerë ishin vizatuar plagë të kuqe, e Ai qante përpara me flamurin në dorë.

"Dita zgjatej në qëndresën e tyre krenare, zgjatej edhe me vite të tëra deri në perëndimin e heshtjes së armëve.

E mëngjesi të zbardhë në fytyrat e tyre pavarsinë..." Atje te rruga e farkëtarëve djaloshi që printe u trand në vend, desh të rrëzohej për toke.

Flamurin e mbante lartë e më lartë, se flamuri nuk bie, as trimi nuk vritet!

Flamurin e ngritë dora tjetër, e dëshmori ngjallet në zemra.

"E mëngjesi të zbardh në fytyrat e tyre pavarsinë..."

Farkim MARAKU

A DO TË FILLOJ VITI I RI AKADEMIK?

Nuk kanë mbetur edhe shumë kohë që të përfundojnë ligjëratat e studentëve të këtij viti akademik 1990/91. Ky vitë akademik filloj me kërcënimet, shantazhe e presione të një pasënëjëshme nga ana e pushtuesit shovenist sérbosllav të cilët sikurse në shumë organizata punuese ku i futën masat e dhunshme nuk i lanë anashë as vatrat arsimore. Një gjë e till filloj

me futjen e masave të dhunshme në Bibliotekën Popullore Universitare në Prishtinë. Edhe përkundër reagimeve e kërkesave të shumta të opinionit demokratik, që të mos pushtohet tempuli i diturisë, pushtuesi shovenist sérbofil që nuk i dëgjoi këto kërkesa por vazhdoi (simbas informatave jozyrtare) me djegjen e librave shqipe si dhe me vuarjen e portreteve të shovenistëve sérbonëdhënë nëpër sallet e leximit, nga të cilët dolën elaboratet famëkeqe për shfarosjen e popullit shqipëtar.

Vazhdoi me futjen e masave të dhunshme në fakultetin e mjeksis, dhe mos vërtetimën e semestrit dimëror të studentëve të fakultetit të mjeksisë, të cilët faktikishtë e humbën këtë vité shkollorë. Edhe përkundër asaj se studentët e këtij fakulteti së bashku me disa profesor të tyre shumë herë u tubuan për të shorehur paknaqësinë dhe revoltën kundër këtyre masave, fakulteti prapseprapë nuk i filluan mësimet.

Ardhja e një urdhërese me plot kërcënime nga ana e bashkësisë së shkollave të larta të Sérbisë ku kërkohet nga shkollat e larta të Kosovës të zgjedhinë nga një delegatë në këtë bashkësi, ku faktikisht shkollat e larta të Kosovës hynë në kuadër të universiteteve të Sérbisë, me q'rastë u pritë me keqëardhje si nga ana e profesorëve ashtu edhe nga ana e vetë studentëv.

Pushtuesi shovenist sérbonadh në çdo mënyrë mundohet të shkatrroj çdo gjë që është shqipëtarë.

Afati regjistrimit të brucoshëve të rinjë tash më u afrua, e Kuvendi i Universitetit të Kosovës as që funksionon e lëre me të dalë me vendim për regjistrimin e studentëve.

A thua vallë ç'duhet të bëjmë ne studentët si pjesë më vitale e kombitë? Të marrim napa konkret që ta mbrojmë univerzitetin e Kosovës, apo të presim e të shofim ç'do të bëhet me ne. Në qoftëse mbrenda këtij muaji nuk arrijmë të ndërmarrim diqka, vallë a do të jemi të sigurtë se në tetorë do të hapen dyertë e universitetit

ILIR POPAJ



DHJETEVJEQARI NE DHE EUROPASOT

Në pranverën e këtij viti vatrat tona familjare, arsimore e kulturore u bënë vatra përkujtimi të shpërthimit revolucionar të masave të gjëra populllore të vitit '81. Duke mos e shkëputur kështu për asnjë çast këtë pjesë të historisë së lavdishme nga kontinuiteti i ngjarjeve me një vlerë shumë të çmueshme në historinë tonë kombëtare, njëkohësisht përkujtojmë që nga Lidhja e Prizrenit, shpalljen e Pavarsisë më 1912, angazhimin e popullit tonë në Luftën e Dytë Botërore për çlirim nacional e social e në vazhdën e saj Konferencën historike të Bujanit, angazhimin e forcave më të shëndosha menjëher pas LDB-së në kundërvënje të ripushtimit Jugosllav, demonstrata masovike të vitit 1968 me një vazdimësi konsekiente prore gjerë më sot për realizimin e çlirimt komëtar të popullit shqiptar në trojet e veta të pushtuarë afér një shekulli.

Këtë luftë heroike kaq të gjatë e barti mbi supe populli shqiptar me bijtë më të mirë të tij. Meqë një numër ranë dëshmorë në realizimin e këtyre idealeve patriotike, ideale për të cilat ne sot vazhdojmë me këmbëngulje të luftojmë në këto raste çdokund për një minutë ju bënderim gjithë dëshmorëve të kombit që ranë në fushë të nderit.

Në këtë kohë kur përballe furtunave të dukshme e të padukshme, të sotme e të nesërme nga qeveritë e ndryshme të shteteve e të supershteteve popujt po njështen, angazhimi ynë është për themlin të unitetit kombëtar.

- unitet i cili mendojmë se duhet të realizohet pavarsisht prej ndryshimeve të mundshme në botkuptimet që partitë politike aplikojnë sot në Kosëvë,

- unitet i cili kërkon patjetër shpërthimin e barierave partiake,

- unitet i cili në asnjë mënyrë nuk do të lejoj që të rikomponohen federatat e konfederata mbi kurrisin e popullit shqiptar.

Ne si rini studentore angazhimin në parti politike thjeshtë, e kemi kuptuar si mundësi më të madhe për të dhënë kontributin tonë aq të nevojshëm atdhet-

ar, e jo kursesi angazhim për pushtet, ngase e mendojmë si absurditet angazhimin e kujdoçoftë për pushtet në kushte të okupimit. Thjeshtë nuk mund të qëndrojnë përballe e as paralel lufta për pushtet dhe lufta për çlirim kombëtar - dihet mirëfilli se cilën rrugë favorizon populli.

Ne si pjesë gjeografike e Ballkanit dhe si populli më i lashtë me kulturë e qytetrim jemi në Evropë, andaj zhurmën që bëhet për integrimin tonë në Evropë e kuptojmë vetëm si të tillë, domethënë zhurmë me efekte negative në shiqimin real të pozitës sonë të sotme të rëndë përderisa nuk shtrohen drejtë raportet Evropë - popull shqiptar i integruar në një shtet shqiptar në trojet e veta në Ballkan që do të paraqiste forcë kohezive për Ballkanin dhe Evropën. Prandaj përderisa çështja nuk shtrohet në këto baza ne Evropën e njohim ashtu si ka qenë dhe si është prore. Çështjet kardinale nuk nxjerrën në tavolinë për shqyrtim dhe zgjidhje për hirë të lajkave që ne do t'i bëjmë Evropës, sepse politika nuk mbështet mbi logjikën e lajkave, por mbi logjikën e interesit. Të kemi kujdesë pra, që të mos vie në shprehje interesi i njëanshëm por interes reciprok sepse dominimi i interesit të fortit do të ishte fatal për ne.

Mardhënjet e reja mbi të cilat preten don të ndërtohet Evropa duhet të jenë fillimi i fundit, vërtet të vonuar, të një etape historike ku shqiptarët kishin njërin prej rolevë më tragjike. Opinion politik i krijuar mbi këto mardhënje nuk guxon të lejoj që të përfundoj ky shekull dhe shqiptarët përsëri tu shërbënisi trofe lufte.

Kohërat e tillë duhet të kenë perënduar. Një kshilltar i urtë na porositë:

"Njerëzit e mëdhenjë (supershtetet) duhet t'i respektosh por jo edhe t'u besosh"

Bujar QERIMI
student i SHLT Ferizaj

VESHTRIM

Sa e kuptojmë ne politikën, dhe sa i qasemi asaj nëse ndalemi si para paqyrës së një jete, dhe kundruall saj lozim me vijat e qëndisura për fatin apo kufijtë.

Andaj nëse çmohet politika nga një këndëvështrimi, dhe parimiteti nuk përket me vetëkritikën, atëherë jemi të ngushtuar me një automizim!... E për të, s'është as koha, as populli.

Qyteti ynë si një kullë e pamposhtur qëndron para çdo gjëje të pazakonshme,

- Fabrikat e pushtuara, me mijë punëtor të nxjerrur nga puna. Shkollat pa finansimi, drejtorët e tyre dhe arsimtarët mirren në pytje dhe maltretohen. PTT-ja etnikisht e pastër me sérbofil e romë (të vetquajturit egjiptian).

Banka e Kosovës e plaqkitur dhe barrë mbi shkrimet proslave. Zejtaritë private të mbyllura dhe të ngarkuara me dëni me tatime drastike. Godina e komunës e shëndrruar në kuestur inspeksionesh, etj. etj.

Cfar kan arritur me këtë?

- Formimi i Sindikatave të Pavarura, Lidhjes Demokratike, Partisë Demokratike Fshatare, Forumit të Intelektualëve, shoqata e inxhinierëve, juristëve, shoqata bëmirëse "Nëna Terezë", shoqata përkthimin e shqiptarëve të shpërngulur, Unioni i Studentëve, Unioni i Nxënësve, etj. etj.

Këto asnjëren nuk i kemi gëzuar më parë.

Ferizaji është votër trimash, patriot e liridsashës, andaj nuk i mungon tjetër, veq thirrjes së nën Kosovës për bashkim kombëtar...

Raif MUSA

LULEBORA E PAJTIMIT

Ende diku-diku nuk iste shkrirë bora, kurse shenjat e para të pranverës shiheshin në luleboret e para.

Lulebora e parë qeli me 2 shkurt 1990 e pastaj anë e këndë Kosovës lulëzoi kjo luleborë...

Kudo jehonte zëri i popullit. "Në këtë vitë duhet të falen të gjitha gjaqet në Kosovë", kudo mbërrinte ky zë dhe kufij nuk njifte fare.

Në Ferizaj kjo lulebore qeli në fillim të marsit, studentët e shkollës së lartë teknike me krahun e profesorëve ujitën këtë lulebore me gjaqet e kësaj ane. Lulet e saj preknin majat e kullave krenare, në çdo degë të saj duart të shtrira, e në çdo fletë lotë gëzomi...

Kush shtriu dorën e fali në jehonën e kushtimit;

Çdo shqiptar ishte anëtar i KËSHILLIT TË PAJTIMIT të Feritajit

KËSHILLI I PAJTIMIT- Ferizaj

Bardhyl LONDO

VDEKJA E TRADHTARIT

..Dhe s'kishte asnjë karvan të përzishëm, s'kishte kurora, as njerëz kokëjashtë, pas arkivolit çapitësi enigmë vetëm një qen me gjuhën gjithë jarge.

Vetëm një qen pas karrocës së zezë nga lodhja, nga uria rënkon pa zë, mbi ndenjësen prej dërrase karrocierin gati gjumi po e zë..

I shtrirë në arkivol, i përbuzur, mbështjellë nga qesini i urrejtjes sone, gjithë jetën ëndërrroi që këto rrugë t'i shkelnin kontër dhe barone.

Ti gjakoste rrugët qizme e huaj («sinjor», «mister», «herr»), mbi gjoksin e qytetit të varej Ruga «Jeu krisht», shetitore «Hitler».....

Dhe ja tanë me ëndrrat e kobëshme, shtrirë pa srym në karroceri, për shpresat gjetherëna, rrënjjeprrera, derdh jargë vetëm një qen i zi.

Feride PAPLEKA

DËSHMI NË EMËR TË ARDHMERISË

(mendime për romanin

"GJARPRINJTË E GJAKUT"

të Adem DEMAÇIT)

Kush mund ta merrte me mend se romani GJARPRINJTË E GJAKUT do të rishfaqej plot dritë e finesë tanë pas tridhjet e ca vjetësh. Një mungesë kaq e gjatë e veprës dhe e autorit të saj me qëllimin e mbрапsht zhdukjen, mbylljen e gojës së autorit ose mbulimi në heshtje deri në arrest është gati-gati tragjike. Mendimi shkon larg deri tek përfytyrimi i ngrirjes së një laboratori të tërë krijues të rrallë nga ata të llojit të papërsëritshëm dhe arsyetimi përplaset pastaj në boshtin e llahtarshëm të ngrehinës së pikëlluar të veprave që nuk u shkruan.

Adem Demaçi, ky shkrimitar martir do të ketë ruajtur vallë pak sa nga ai zjarr i dikurshëm i shpirtit të tij, për të ngrohur zemrat tona të etura sot më shumë se kurrë për dashuri njerzore. Megjithëatë dëshmja në emër të ardhmerisë nuk mund të shlyhet dhe frymzimi i njejtësuar në endrrën e popullit nuk vdes kurr. Dhe shkrimitari që bëhet hero do të rroj sa rron heroizmi. A nuk përbëjnë një shumsi veprash këtë?

Subjekti i romanit pasqyron anën më dramatike të jetës së shqiptarit, gjakmarjen, kolin e pamëshirshëm që binte mbi institucionin e familjes mbi, mardhënjet ndërfamiljare e ndërfisnore, për ti rrudhur dalngadal këto të fundit thjeshtë në mardhënje gjaktësie. Është një dramë aq e ndërlikuar dhe aq e dhimbëshme sa nuk mund ti përgjasoj asnjë lloj trillimi sado ogurzi që të jet ai. Një dramë e përgjakur breznish të gjymtuara, të tjetësuara, të humbura tragjikisht. Aktet e saj të fundit janë luajtur e riluajtur gjer vonë në trevat shqiptare përtëj kufirit në Jugosllavi, doemos dikujt i ka interesuara që këto akte të lara me lot e mjerim të mos kishin fund kurrë sepse kosa e gjakmarrjes, si ai helmi i prodhuar për vetëasgjësim, ishte më e frytshme se dora e atyre që përpilnin në mënyrë të ethshme projekte për shfarosjen e racës shqiptare. Por në fundë të këtij shekulli, pas një rruge të gjatë të mundimshme populli i Kosovës heroike gatoi nga indet e trupit të tij të plagosur një mesazh tejet madhorë për nga madhështia e humaniteti GJAKFALJEN, i papërfytyrushëm dhe djegëse për kastat që mbanin në duar spektatorët e tragjedisë së pambaruar shqiptare, një akt sublim plotsisht i pritshëm prej një race të lashtë e fisnike.

Në realitetet e reja të mendësisë kosovare kulti i veprës së Adem Demaçit fiton të drejtën e profecisë, përpunimi i sotëm shpirterorë, i atjeshëm, i kryer nga figura të ndritura të kombit tonë u ideua përpëra gati tri dekada e gjysëm nga një birë i denjë i truallit shqiptarë dhe po kaq i denjë në përfaqsimin e tijë në letra. Thirrjen në katër vargje që hap romanin ku rrezëllin si diamant fjala

P A J T I M është njëherësh edhe një betim për blatin zermash, disi e pabesueshme për një djalosh njëzetvjeqar. Në të shumtën e rasteve në këtë moshë bëhen sprova letrare dhe jo përkushtime të thella shpirterore. Adem Demaçi është që në krye një patriot i lindur dhe njeri i madh, ai që në krye është shkrimitar i vërtetë, vetëdije e të folurit, ai që në krye është stilist i përkryer. Si ai udhërrëfyes i regjur e i urt, Demaçi i ri të futë në labirinthet më prekse të personalitetit njerëzor, labirinthet e dhimbjes, përmasat aty janë të pamatshme thuaja se universale. Rrethimi me një lëndë tejjetsore ku zënë vendë të natyrshëm njerëzit, fjalët, dashuritë, lumturia, marrëzia, rrugët, pemët, bari, shtëpitë, dielli, drita e hënës, yjet kuptuar si një planet i vogël për nga uniciteti i organizimit shkon drejt mbylljes si drejt një fundi të pashmangshëm. Të duket se një forcë tinzare, si ajo bisha që përgjon, është duke përgatitur kurthi dhe hataja ndodh: tetë kufoma të shtrira brenda disa minutash si në një lojë ironike, tetë kuje, tetë plagë të hapura që rrjedhin gjak dhe që kërkojn gjak vazhdimisht. Lexuesi i kthehet romanit edhe njëher të zbuloj atë të padukshme të sertë, të gjejë midis fjalëve një fjalë, një shkak. Por s'ka helen si në luftën e trojës. Filli është tepër i largët. Atëhere kur njeriu i parë i pafajshëm ra përblys i vdekur nga një dorë vrastare. Akuza është e rëndë! Mjaftë më! Drama mbaroi. Qdo përpjekje për shpjegim është e kotë, nënteksti është i hapur, ajo që thuhet u thuhet zemrës, eshtrave, gjakut.

Të ky roman, si tek të gjitha veprat e klasit të parë, gjithçka është njëkohësisht e kapshme dhe eterike sepse gjithçka është sintezë. Sinteza kupton analizën e hollësishme që mbetet e padukshme, si pjesa më nyiore e Ajsbergëve, një cilësi e punës së gjenive. Stili konçiz, bukuria dhe begatia e shprehjes, idetë bashkohore dhe ndjenjat humane që e përshkojnë i jepin romanit "Gjarprinjtë e gjakut" të Adem Demaçit vlerat e një vepre që meriton të radhitet ndër më të mirat e letërsisë shqipe.

***** ANKETË ME STUDENTËT E SHLT-s

- * Fati i Universitetit të Kosovës;
 - * Si të dalim nga gjendja e okupimit;
 - * Roli i partive politike.
- *****

Ishin këto tri pyetje të cilat komisioni aketues ua parashroi disa studentëve. Të anketuarit shprehën opçione të ndryshme rreth pyetjeve të parashtruara.

Bekim HOXHA: Për fatin e Universitetit të Kosovës mendoj që ky institucion i lartë shkencor të veproj i pavarur dhe në pajtim me Ministrinë e Arsimit të Republikës së Kosovës. Daljen nga gjendja e okupimit e shofë aktualisht përmes jetësimit të Kushtetutës së Kaqanikut, kurse rolin e partive politike sot e shofë përmes një uniteti dhe bashkëpunimi intensiv.

Mendime të ngjashme shprehën edhe studentët: Ismail Bushi, Elife Vrella, Muharrem Gashi etj.

Fane QORRAJ apelon te të gjithë studentët te të gjithë studentët që me vendosmëri, durim dhe mençuri të ecin përpara e kursesi me forma tjera.

Illir ÇERIKINI është i mendimit se roli i partive politike në rend të parë duhet të jetë ai rreh harmonizimit të problemit të qështjes kombëtare në përgjithësi, duke marrë parasyshë se okupatori nuk është anglez apo amerikan por është barbarë sllav, andaj dalja nga situata okupuese duhet menduar mirë si në lojën me shah!

Bajram REKHEPI mendon se Unoversiteti i Kosovës ka forcë t'i përballoj kësaj

stuhie me urtësi, mirëpo armiku nuk ka njete mirëkuptimi. Si do të përgjigjemi do të tregoj koha.

Të njejtin mendim e kishin edhe studentët: Bekim Fejzullahu, Neki Morina, etj.

Studentët: Ejup Kopalla, Gëzim Hagjimusa, Fatmir Hyseni, Bajram Jaha dhe shumë të tjerë janë të mendimit se Tempulli i diturisë, Universiteti i Kosovës duhet të mbrohet me të gjitha mjetet dhe format që disponojmë, pra edhe em luftë.

Fatmir HIZIRI është i mendimit se gjendjen e vështirë që e ka përfshirë Universitetin e Kosovës do ta kalojm lehtësisht në këtë ankth politik.

Heset SHALA mendon e Universiteti i Kosovës asnjëher në historikun e vet nuk ak qenë në situatë më të vështirë, përkapercimin e kësaj situate nevoitet angazhim së pari nga presidenca Jugoslave e cila momentalisht punon me direktiva të Serbisë hegemoniste e pastaj angazhimi i mbar opinionit demokratik European e më gjerë.

Anketën e zhvilluan:

Ilir POPAJ
Mustafë GASHI
Bujar BAJRAKTARI



FJALË TË URTA SHQIPE

- 1. Ai që ndërton me djersë, mronë me gjak
- 2. Ai që bëhet i ertë si delme, e hanë uqtë
- 3. Buka e botës s'të ngop
- 4. Dora e vet ka kimet; dora e botës-mortajë e kokës
- 5. Më mirë nën dhe i mbulur, se mbi dhe i gjunjëzuar
- 6. Mikun nderoje dhe veie në qoshqet, po zot shpije të jesh vetë
- 7. S'vritet gjarpri me dorën e huaj
- 8. Hyqmeti është si uji e popull si


- zalli: se ai tretet, e zalli mbatet.
- 9. Nxirr nga dhit, e bëjë zabit
- 10. Amerika të jep një thele mish e të merr lopën me gjithë viq
- 11. Ha dhe, dorën tjetrit mos ia zgjat
- 12. Xhematit ni herë në krye qekiq, e imamit dy herë
- 13. Arma ta prun kreun, arma ta prun atdheun
- 14. Duaje atdhenë si shqiponja folenë
- 15. Kush ka vdek për atdhe, nuk ka vdek po ka lo
- 16. Arma ma e mirë e armikut është tradhëtin
- 17. Fjalë e burrit-pushka e murit

FLETË TESTAMENTI

JUSUF GERVALLA

në zgjimin tim më të heshtur të më ngurosin
në slijimin tim më të begatshëm të verës
në nisjen time në fillimin tim të ri
në gjumë shekujsh me ndërrime të më zgjojnë
le të më puthë rrezja e qartë ngazëllye se
e dravarit të fjetur në rudinë
myshku le të jetë gjithmonë i blertë mbi gurë
emër të mos ketë e shkronja le të flasë
në gjuhën e vjetër të kasshës së zezë
guaca e kërmij le të vijnë për dasmë
mbi rrasën time
le të shtrihen edhe ata si dy yje
stohtë le të bëjë verës e verës verë
e me një pikë ujë verdhësisë së barit tim
le t'i mëshirohen
vermëni atje tek do të tregojë guri për udhën
deri te shtëpia ime bëre me dru e kashtë

le të thyhet çdo pasqyrë që ka ballsamosur
ballin tim e mërrrolën e çastit plot mllaf
se ja tek po zgjohet er' e re e dashurisë së tokës
se jam i parrezikshëm kaq i pasuqishëm
mumje përfytyrim që krahasohet me rrahun
tek do të më vini përsëri ju pas
le të më lënë të fle qetë si pranë stufë
dimrit të madh të dashurisë sime
nuk do të përpëlitem s'do të rrotullohem
s'do të shplohem natën nuk do të kollitem
me fjalët e mia le të më mallkojnë
në rrasën time atë rrasë të zezë të stohtë
në duart që i kam prekur le të më lëshojnë
rrjedhës së qetë të fatit që pret
shigjet e mërisë le të bjerë mbi dhë
në shkretëtirën e moskuptimit le të fiket
kurrë të mos më vijnë kur unë nuk i pres
ata që tërë jetën i prita, të dashurit
ç'po flas kështu pash zotin?






VEPRIM E JO FJALË, BASHKIM E JO PËRÇAMJE

HASAN PRISHTINA

Vllazën! Kërkojnë prej nesh që atdheun ta trajtojmë si mall tregu. Jo, kurrë! Si dje, sot nesër e përherë, atdheu ka qenë dhe asht gjaja ma e shejtë për ne. Të gjithë ta dinë se na nuk jena tue lufte kundër Shqipnisë e shqiptarëve, por përnji Shqipni të lirë e të bashkueme. Nuk kemi dalë maleve me shpëtue vetëm nji shtëpi, katund apo fis, po të tanë Kosovën, e cila mbështjell në gjinie e vet krejt vllaznit, qytetet e katundet tona. Ideja e parulla jone ka qenë dhe asht: çlirim i bashkimi i tanë Kosovës me atdheun tonë të përbashkët, Shqipninë. Dhë për ta realizue këtë, duhet veprime e jo fjalë, bashkim e jo përcajmje, trimni e jo frikë. Na kurrë s'kemi kujtue se lirinë ka me na e sjellë dikush së jashtimi. Jo, njimij herë jo! Atë e kemi fitue dhe do ta fitojmë me gjakun tonë, sepse vetëm kështu ajo mund të jetë nji liri e vërtetë. Vetëm pushka jone e jo dikush tjetër ka detyrue e do të detyrojë anmiqtë të lëshojnë nga duert gërsjanët, me të cilat duen të qethin copa të tjera nga trupi i atdheut tonë. Edimë se anmiku asht ma i shumti në numër, ma i armatosun me armë dhe ma i pasun me pare. Kështu ka qenë dje, kështu asht edhe sot. Por kjo as nuk na tremb, as nuk na përkul, përkundrazi kjo kërkon që na të jemi ma të fortë. Të peshojmë mundësitë tona me guxim e mendje të kthjellët. Na nuk e zvogëlojmë rrezikun, në të kundërt, na u themu lufitëtarëve: rreziku asht i madh, prandaj bashkoni radhët, tregoni vendosmëni e guxim, flaknihtutje burracakët, që mbjellin përcamje e frikë, përbuzni ata që cirren tue na këshillue të dorëzohemi, sepse gjoja do të shuhemi.

Vllazën! Asht e vërtetë se nji gabim taktik gjatë luftës mund të sjellë që kjo apo ajo çetë të thyhet përkohësisht, por kjo s'ka aq randësi përfundin e luftës. Politika e dorëzimit, e pritjes apo e kundërshtimit të aksionit kurrë nuk të çon në fitore. Kush ka frikë, ka me vete humbjen, kush qëndron i patundun, ka me vete fitoren. Liri pa gjak nuk ka.

3 PRILLI, DITËLINDJE



Dhjetë vjetë, o vëlla
shënove në trupin tuaj,
me vija kërbaqi
ditëlindjet...

Dhjetë vjetë, o vëlla
sytë në tyta pushkësh,
për drekë thithje lotësjallsin
e mbrëmjeve vajin e nënave...

Dhjetë vjetë, o Qëndrim
pa gëzim e pa dritë,
që të lindi motra
REPUBLIKË...

Raif MUSA